

**SUPREME COURT OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA**

**KOSOVO PROPERTY AGENCY (KPA) APPEALS PANEL
KOLEGJI I APELIT TË AKP-së
ŽALBENO VEĆE KAI**

GSK-KPA-A-126/12

Prishtinë, 17 tetor 2013

Në çështjen juridike të:

Komunës së K.

Pala ankuese

kundër

K.S. Đ.

Paraqitësi i kërkesës/Pala përgjegjëse në ankesë

Kolegji i Apelit të AKP-së, i Gjykatës Supreme të Kosovës, i përbërë nga gjyqtarët Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, Esmë Erterzi dhe Sylejman Nuredini, anëtarë, duke vendosur në lidhje me ankesën kundër vendimit të Komisionit për Kërkesa Pronësore të Kosovës KPCC/D/C/150/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA15045), të datës 19 prill 2012, pas shqyrtimit të mbajtur më 17 tetor 2013, mori këtë

AKTGJYKIM

- 1- Hedhet poshtë ankesa si e palejueshme.
- 2- Obligohet pala që të paguaj shpenzimet e procedurës në shumën prej 30 € (tridhjetë euro) në pjesë të barabarta brenda afatit prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditësh nga dita e dorëzimit të këtij aktgjykimit nën kërcënimin e përmbarrimit të detyrueshëm.

Përmbledhja e çështjeve faktike dhe procedurale:

Më 23 gusht 2006, K. S. Đ. ka paraqitur një kërkesë në Agjencinë Kosovare të Pronës (AKP), ku ka kërkuar që të njihet si pronar i një prone, një banese me sipërfaqe prej 69.38 m², që gjendet në Klinë, në rrugën Knez Miloš, lamella A bb 4. Atij, së bashku me pjesëtarët e familjes, iu ishte dhënë e drejta shfrytëzimit për një kohë të pacaktuar, sipas vendimit të Komisionit për çështje banesore nr. 360-1905/98-60 të datës 7 maj 1998. Ai ka deklaruar se e kishte humbur posedimin e pronës më 18 qershor 1999 dhe se humbja ishte rezultat i rrethanave të viteve 1998/1999 në Kosovë. Për të mbështetur kërkesën e tij, paraqitësi i kërkesës ka paraqitur në AKP, mes tjerash, dokumentet në vijim:

- vendimin e Komisionit për çështje banesore nr. 360-1905/98-60 të datës 7 maj 1998 për dhënien e së drejtë së shfrytëzimit të banesës së kërkuar paditësit dhe pjesëtarëve të familjes së tij (së bashku me një dokument të veçantë me arsyetimin për vendimin, të datës 13 maj 1998), që është verifikuar pozitivisht nga AKP-ja;
- procesverbalin e dorëzimit të banesës, të datës 14 maj 1998;
- fatura të ndryshme të shërbimeve komunale;

Ekipi i AKP-së ka bërë njoftimin e pronës duke vendosur një shenjë në derën e banesës më 12 korrik 2007. Prona ishte uzurpuar nga M. M., ai ka nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes. Ai nuk ka pretenduar ndonjë të drejtë ndaj banesës.

Me vendimin KPCC/D/C/150/2012 (lënda e regjistruara në AKP me numër KPA15045), Komisioni e ka miratuar kërkesën. Organi vendimmarrës ka konsideruar se paraqitësi i kërkesës ka dëshmuar ekzistencën e

shfrytëzimit të së drejtës banesore, e cila i është dhënë me vendim të Komisionit për çështje banesore të muajt maj të vitit 1998.

Vendimi i është dorëzuar paraqitësit të kërkesës më 27 gusht 2012.

Më 19 shtator 2012, Komuna e K. ka paraqitur ankesë kundër vendimit të KKKPK-së. Pala ankuese pretendon se vendimi përmban gabime thelbësore dhe zbatim të gabuar të së drejtës materiale dhe procedurale. Për të mbështetur qëndrimin e vet, pala ankuese paraqet dokumente të shumta provuese: ujdinë gjyqësorë të datës 10 shtator 2007, listën e regjistrimit të banesave, procesverbalin mbi ndarjen e saj, etj. Pala ankuese pohon se ai nuk ishte informuar si duhet lidhur me kërkesën dhe se nuk ka pasur mundësi që të marrë pjesë në procedurë. Sa i përket meritave të lëndës, ajo pohon se ligji për të drejtën materiale që është zbatuar nga KKKPK-ja nuk ishte më në fuqi në Kosovë.

Paraqitësi i kërkesës është përgjigjur përgjigje në ankesë, duke cekur se ajo është e palejueshme pasi që pala ankuese nuk ka marrë pjesë në procedurën para AKP-së dhe në mënyrë alternative ajo duhet të refuzohet në bazë të meritave të saj.

Arsyetim ligjor:

Ankesa është e palejueshme mbi bazën procedurale (neni 13.3 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079), pasi që pala ankuese nuk kam marrë pjesë në procedurë në shkallë të parë.

Neni 12.1 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 përcakton si në vijim: *"Brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi i palëve nga Agjencia Kosovare e Pronës për vendimin e Komisionit mbi ankesën, pala mund të paraqesë ankesë ndaj vendimit të tillë [..]"*. Po ashtu neni 176.1 i Ligjit 03/L-006 mbi Procedurën Kontestimore parasheh se e drejta për paraqitje të ankesës i përket palëve në procedurë në shkallë të parë.

Palë në kërkesë dhe në procedurën e ndërlidhur është *"Çdo person, përveç paditësit, i cili aktualisht ushtron ose pretendon se ka të drejtë në pronën e cila është objekt i kërkesës ose çdo person tjetër i cili mund të ketë ndonjë interes ligjor në pronën ndaj së cilës është parashtruar kërkesë [...], me kusht që personi i tillë ta informojë Sekretarinë ekzekutive për qëllimin e tij që të marrë pjesë në procedurën administrative brenda tridhjetë (30) ditëve nga njoftimi për kërkesën nga Sekretaria ekzekutive në pajtim me nenin 10.1"* (Neni 10.2 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079).

Pala ankuese Komuna e Klinës, nuk ka qenë palë në procedurë në shkallë të parë para KKPK-së. Për të sqaruar një situatë të këtillë, pala ankuese pohon se nuk ishte në dijeni të procedurës, Në të vërtetë, neni 10.3 i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079 thekson: *“Personi me interes ligjor në kërkesë i cili nuk ka marrë njoftimin mbi kërkesën mund të pranohet si palë kurdoqoftë gjatë procedurës.”*

Prandaj, Gjykata Supreme duhet të kontrollojë nëse pala ankuese ishte njoftuar për kërkesën. Mënyra për të njoftuar për kërkesën në këtë proces të veçantë zgjidhjes grupore të kërkesave është paraparë me nenin 10.1 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079. Sipas kësaj dispozite, Sekretaria Ekzekutive duhet t'i bëjë të gjitha përpjekjet e arsyeshme për të njoftuar çdo person që mund të ketë interes ligjor në pronë e kërkesës. E njëjta dispozitë shton se *“në rastet e dubura, përpjekjet e tilla të arsyeshme do të jenë në formë të një lajmërimi në një botim zyrtar të Sekretarisë Ekzekutive”*.

Gjykata vëren se njoftimi i datës 12 korrik 2007 është realizuar si duhet. Ekipi i AKP-së ka vendosur një shenjë informuese në të tri gjuhët – shqipe, serbe dhe angleze në derën e banesës. Kjo gjithashtu është konfirmuar nga fakti se AKP-ja gjeti një person që e kishte uzurpuar pronën – z. M., i cili e ka nënshkruar njoftimin e pjesëmarrjes por nuk e ka kundërshtuar kërkesën dhe nuk ka pretenduar ndonjë të drejtë të vetën.

Pala ankuese aktuale – Komuna e K. pretendon të jetë pronare e banesës, në derën e së cilës ishte vendosur shenja e njoftimit. Nuk ka arsye se përse Komuna nuk e ka njoftuar AKP-në për qëllimin e saj për të marrë pjesë në procedurë, gjë që është dashur ta bëjë.

Pasi që Komuna nuk ka arsyetim se përse nuk kishte marrë pjesë në procedurë në shkallë të parë para AKP-së, ky lëshim shkon në dëm të saj.

Prandaj, ankesa duhet të hedhet poshtë si e palejueshme (neni 13.3 (b) i Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin nr. 03/L-079; shih po ashtu nenin 195.1 nën paragrafi (a) të Ligjit për Procedurën Kontestimore).

Pasi që ankesa është e palejueshme, Gjykatës Supreme nuk i lejohej që as të vë në pikëpyetje juridiksionin e KKPK/Kolegjit të Apelit të AKP-së e as çështjet ligjore lidhur me blerjen e ngastrës.

Shpenzimet:

Në përputhje me Shtojcën III, nenit 8.4 të Urdhërësës Administrative (UA) 2007/5 e ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-079, palët lirohen nga shpenzimet e procedurës para Sekretarisë Ekzekutive dhe Komisionit. Megjithatë, një përjashtim i tillë nuk është i paraparë për procedurat para Kolegjit të Apelit. Si pasojë, regjimi normal i pagesës së taksave gjyqësore të paraparë më Ligjin mbi Taksat Gjyqësore (Gazeta Zyrtare e KSAK-së, 3 tetor 1987) dhe me UA Nr. 2008/2 të Këshillit Gjyqësor të Kosovës mbi unifikimin e taksave gjyqësore janë të vlefshme për procedurat para Kolegjit të Apelit.

Kështu që, taksat e mëposhtme të gjykatës zbatohen për procedurat aktuale të apelit:

- Tarifa nga taksa gjyqësore për paraqitjen e ankesës (neni 10.11 i UA 2008/2): 30 €

Kjo taksë gjyqësore duhet të merret përsipër nga pala ankuese e cila humb rastin.. Sipas nenit 45 të Ligjit mbi Taksat Gjyqësore, afati për pagesën e këtyre taksave është 15 ditë. Neni 47 paragrafi 3 parasheh që në rast se pala nuk paguan taksën brenda afatit, pala do të duhet të paguaj një gjobë prej 50% të shumës së taksës. Nëse pala nuk e paguan taksën në afatin e dhënë, atëherë bëhet ekzekutimi i detyrueshëm i pagesës.

Këshillë ligjore:

Në përputhje me nenin 13.6 të Rregullores së UNMIK-ut 2006/50 të ndryshuar me Ligjin 03/L-079, ky aktgjykim është i plotfuqishëm dhe i detyrueshëm dhe nuk mund të kundërshtohet me mjeteve të rregullta apo të jashtëzakonshme juridike.

Elka Filcheva-Ermenkova, Kryetare e Kolegjit, EULEX

Esma Erterzi, Gjyqtare e EULEX-it

Sylejman Nuredini, Gjyqtar

Urs Nufer, Referent i EULEX- it